

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditëses [REDACTED], dega në Shtime Rr. [REDACTED], të cilën me autorizim e përfaqësojë [REDACTED], kundër të paditurve [REDACTED] dhe [REDACTED] të dy nga fshati [REDACTED] Komuna e Shtimes, baza e kontestit pagimi i borxhit nga kontrata mbi huanë, me datë 01.12.2016 merrë këtë:

A K T G J Y K I M
(NË BAZË TË POHIMIT)

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] dega në Shtime Rr. [REDACTED] dhe DETYROHEN të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] të dy nga fshati [REDACTED] Komuna e Shtimes, që në mënyrë solidare t'ia paguajn paditëses në emër të përmbushjes së kontratës së huasë shumë prej 354.00 Euro, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, e nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

II. DETYROHET të paditurit [REDACTED] dhe [REDACTED] të dy nga fshati [REDACTED], Komuna e Shtimes që në llogarinë e ksaj Gjykate të paguajn taskën për përpilimin e këtij Aktgjykimi në shumë prej 15 Euro në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njejtit, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja me datë 24.01.2014 ka parashtruar padi kundër të paditurve për pagimin e borxhit nga kontrata mbi huanë.

Gjykata ka caktar seancën për shqyrtimin përgaditor dhe atë kryesor me datë 29.11.2016, në të cilën kanë qenë prezent përfaqësuesi i paditëses dhe të paditurit. Në po këtë seancë të paditurit e pohojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses në shumë prej 534.00 Euro dhe i propozojë Gjykatës të aprovonë në tërësi si të bazuar. Deklarata e shprehur e palëve të paditura (expressis verbis) është veprim procedural dhe i njëanshëm dhe pas vlerësimit nga ana e Gjykatës se një pohim i tillë është në përputhje me ligjin dhe palët ndërgjygjëse mund të disponojnë me këto kërkesa merrë këtë Aktgjykim në bazë të pohimit dhe e aprovonë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses.

Nuk mund të ketë aktgjykim në bazë të pohimit në rastet kur palët nuk mund të disponojnë lirisht me objektin e kontestit dhe se kur disponimet e palëve ndërgjygjëse janë në kundërshtim me dispozitat e detyrueshme, në rastin konkret Gjykata ka vlerësuar se palët ndërgjygjëse disponojnë me të drejtat objekt kontesti dhe janë në përputhje me dispozitën e nenit 148 të LPK-së. Meqenëse të paditurit i pohuan faktet e çështjes në tërësi, Gjykata nuk lëshohet në vërtetimin e gjendjes faktike.

Baza Ligjore

Në nenin 148 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet paragrafët: 1 “Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”; 2 “Gjykata nuk e jep aktgjykimin në bazë të pohimit, edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme, po që se konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të këtij ligji)”; 3 “Dhënia e aktgjykimit në bazë të pohimit mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që për rrethanat nga paragrafi 2 i këtij neni të merren njoftimet e duhura”; 4 “Deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë i padituri mund ta revokojë verbalisht në seancë gjyqësore, apo me anë të parashtrësës jashtë seancës gjyqësore, edhe pa pëlqimin e paditësit, deri në momentin e dhënies së aktgjykimit”.

Andaj nga të theksuarat më lartë, e duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.47/14, me datë 01.12.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFQUISHËM
ODLUKA JË PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,
FERIZAJ I UROŠEVAC
10.01.2017


Gjyqtari,
Ardian Ajvazi


Këshilla Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njejtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.